

VENDIM
Nr.33, datë 18.1.2012

PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 382 M², TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2529, ME NUMËR PASURIE 568/12, LUNDËR, TIRANË, QË DO TË TJETËRSHOHET NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “UNION GROUP” SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr.568/12, në zonën kadastrale 2529, me indeks harte K-35-100 (45-B), Lundër, Tiranë, me sipërfaqe 382 (treqind e tetëdhjetë e dy) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Union Group” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të përllëgaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Union Group” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha